

NEOPOZITIVIZMI DHE KRITIKA E TIJ NDAJ METAFIZIKËS

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË FILOZOFI
NGA
MIMOZA GURI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I FILOZOFISË

Prishtinë
Qershor, 2026

REZYME E TEZËS MASTER

NEOPOZITIVIZMI DHE KRITIKA E TIJ NDAJ METAFIZIKËS

Mentori: Prof. Ass. Dr. Kristë Shtufi

Kandidatja: Mimoza Guri

Hyrja

Studimi trajton neopozitivizmin dhe kritikën e tij ndaj metafizikës, duke analizuar një nga debatet më të rëndësishme të filozofisë moderne dhe bashkëkohore. Në hyrje paraqitet konteksti historik dhe filozofik i lindjes së neopozitivizmit, i zhvilluar kryesisht nga Rrethi i Vjenës gjatë shekullit XX. Shpjegohet ndikimi i filozofëve si Rudolf Carnap, A.J. Ayer dhe Otto Neurath, si dhe rëndësia e logjikës moderne dhe shkencave empirike në formimin e këtij drejtimi filozofik. Vëmendje e veçantë i kushtohet parimit të verifikueshmërisë, sipas të cilit një pohim konsiderohet kuptimplotë vetëm nëse mund të verifikohet përmes përvojës empirike ose analizës logjike. Gjithashtu, hyrja paraqet edhe kritikën kryesore ndaj neopozitivizmit nga filozofë si Karl Popper, W.V.O. Quine dhe Ludwig Wittgenstein.

Qëllimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë raportin ndërmjet neopozitivizmit dhe metafizikës, duke shqyrtuar argumentet neopozitiviste kundër metafizikës dhe duke vlerësuar kufizimet e kësaj qasjeje filozofike. Studimi synon të tregojë nëse parimi i verifikueshmërisë mund të shërbejë si kriter i qëndrueshëm për dallimin ndërmjet pohimeve kuptimplota dhe atyre të pakuptimta. Po ashtu, synohet të analizohet ndikimi që neopozitivizmi ka pasur në zhvillimin e filozofisë analitike dhe filozofisë së shkencës.

Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit mbështetet në analizën konceptuale, hermeneutike, krahasuese dhe kritike. Përmes analizës konceptuale shqyrtohen nocionet kryesore si kuptimi, verifikueshmëria dhe metafizika. Metoda hermeneutike përdoret për interpretimin e teksteve filozofike klasike dhe bashkëkohore, ndërsa metoda krahasuese ndihmon në analizimin e

dallimeve ndërmjet neopozitivizmit dhe kritikëve të tij. Qasja kritike mundëson vlerësimin e forcës dhe kufizimeve të argumenteve neopozitiviste.

Pyetjet e Studimit

1. Cilët janë burimet historike dhe konceptuale të neopozitivizmit dhe parimit të verifikueshmërisë?
2. Si argumentojnë neopozitivistët se pohimet metafizike janë të pakuptimta?
3. A janë teorikisht të qëndrueshme kriteret e kuptimësisë të propozuara nga neopozitivizmi?
4. Cilat janë kritikrat kryesore të Wittgenstein-it të vonshëm, Quine dhe filozofëve bashkëkohorë ndaj neopozitivizmit?
5. A ruan ende vlefshmëri kritika neopozitiviste ndaj metafizikës në filozofinë bashkëkohore?

Përmbajtja e Kapitujve

Kapitulli I

Në këtë kapitull paraqitet baza teorike dhe historike e studimit. Trajtohet lindja e neopozitivizmit, parimet themelore të tij dhe rëndësia e debatit mbi metafizikën në filozofinë moderne. Gjithashtu, prezantohet problemi kryesor i studimit, rëndësia teorike e tij dhe ndikimi që neopozitivizmi ka pasur në zhvillimin e filozofisë analitike dhe të filozofisë së shkencës.

Kapitulli II

Ky kapitull fokusohet në analizën e literaturës klasike dhe bashkëkohore mbi neopozitivizmin dhe metafizikën. Trajtohen origjina historike e neopozitivizmit, parimi i verifikueshmërisë dhe kritikrat ndaj metafizikës. Gjithashtu, shqyrtohen interpretimet dhe kundërshtimet e filozofëve si Quine, Popper dhe Wittgenstein, të cilët kanë vënë në pikëpyetje kufizimet e neopozitivizmit. Një pjesë e rëndësishme i kushtohet edhe tensionit ndërmjet racionalitetit logjik dhe kontekstit shoqëror.

Kapitulli III

Në këtë kapitull shpjegohen qasjet metodologjike të përdorura gjatë realizimit të studimit. Përshkruhen analiza konceptuale, hermeneutike, krahasuese dhe kritike, si dhe rëndësia e tyre në trajtimin e debateve filozofike. Po ashtu, paraqiten qëllimi i studimit, pyetjet kërkimore dhe procedurat e ndjekura për analizimin e argumenteve filozofike.

Kapitulli IV

Ky kapitull përmban analizën kryesore filozofike të punimit. Shqyrtohen argumentet kryesore të neopozitivizmit, roli i gjuhës dhe logjikës, parimi i verifikueshmërisë dhe implikimet epistemologjike të tij. Gjithashtu, trajtohen kundërshtimet klasike dhe bashkëkohore ndaj neopozitivizmit, duke përfshirë kritikën e Popper-it, Quine-it dhe Wittgenstein-it. Në këtë kapitull bëhet edhe analiza krahasuese ndërmjet neopozitivizmit dhe qasjeve bashkëkohore ndaj metafizikës.

Kapitulli V

Në këtë kapitull paraqiten rezultatet kryesore të studimit. Theksohet se neopozitivizmi ka pasur ndikim të madh në zhvillimin e filozofisë analitike dhe në rritjen e rigorozitetit logjik të analizës filozofike. Megjithatë, përpjekja për eliminimin e metafizikës nuk ka qenë plotësisht e suksesshme, pasi shumë pyetje metafizike vazhdojnë të mbeten relevante në filozofinë bashkëkohore. Gjithashtu, paraqiten rekomandime për studime të ardhshme dhe për qasje më fleksibile ndaj marrëdhënies ndërmjet filozofisë, shkencës dhe metafizikës.

Përfundimet

Studimi arrin në përfundimin se neopozitivizmi ka luajtur rol të rëndësishëm në transformimin e filozofisë moderne, veçanërisht përmes analizës logjike të gjuhës dhe insistimit në rigorozitet metodologjik. Megjithatë, kritikën ndaj parimit të verifikueshmërisë kanë treguar kufizimet e kësaj qasjeje filozofike. Metafizika nuk është eliminuar nga filozofia bashkëkohore, por është transformuar dhe riformuluar në forma më të disiplinuar dhe më të lidhura me analizën konceptuale dhe shkencën. Në përfundim, studimi argumenton se neopozitivizmi dhe metafizika nuk duhet të shihen si kundërshtime absolute, por si pjesë të një dialogu filozofik të vazhdueshëm që ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin e filozofisë moderne dhe bashkëkohore.